



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:095096

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05763733

C.nr.1076/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Vushtrri – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtarin Naim Rekalii, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.Sh nga Vushtrria, të cilën me autorizim e përfaqëson av. K.F nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, lidhur me pagesën e shujtave ditore, vlera e kontestit 736.00 euro, jashtë seancës me datë 31.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit E.Sh nga Vushtrria dhe DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën nga data 21.03.2021 e deri me datë 21.11.2022, për 368 ditë pune, t’ia paguaj paditësit E.Sh shumën prej 736.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 13.03.2024 e deri në pagesën definitive, ne afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë për padi shumën prej 104.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 21.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi E.Sh nga Vushtrria, nëpërmjet të autorizuarit te tij av. K.F, me datë 13.03.2024 ka paraqitur padi, kundër të paditurës Komunës së Vushtrrisë, me të cilën kanë kërkuar që të

obligohet e paditura që të t'a kompensoj shpenzimet e ushqimit për periudhën nga data 21.03.2021 e deri me datë 21.11.2022 atë në shumë të përgjithshme prej 736.00 euro, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Me përgjigjen në padi të datës 20.05.2024, e paditura e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar ne mes te MASHT-i dhe SBASHK-u janë nënshkruese te kësaj marrëveshje dhe te paditurës i mungon legjitimiteti.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palës nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *“kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”*, si dhe vërtetimit i lëshuara nga Institucioni arsimor SHFMU “ ...”, në fshatin ..., Komuna Vushtrri, i datës 06.06.2023, u vërtetua se paditësi, për periudhën kohore prej datës 21.03.2021 e deri me datën 21.11.2022, ka punuar për 368 ditë, andaj edhe gjykata ia njohu shumën prej 736.00 euro, duke përllorë një ditë pune me 2,00 euro (368 ditë x 2€ =736.00€).

Në anën tjetër për gjykatën nuk mund të qëndroj pretendimi i të paditurës se pasi që ajo nuk ka qenë nënshkruese e Kontratës Kolektive, asaj i mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje. Kjo ngase në radhë të parë e paditura është punëdhënës i paditësit dhe janë në një raport kontraktual të marrëdhënies së punës e po ashtu faktit se KKA-ja është e lidhur në nivel vendi, me efekt të zbatueshëm në të gjithë Republikën e Kosovës. Lidhur me këtë me nenin 90, par 2.1 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, është paraparë që *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në nivel të vendit”* dhe mbi këtë bazë kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në K KKA-së nr. 2056 dhe asaj nr. 105, të lidhura në mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në njërën anë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) në anën tjetër.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditësit ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartës prej 8% në vit, duke llogaritur nga data 13.03.2024 dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, për kamatën, me nr.265/2020 i datës 01.12.2020.

Gjykata vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shpenzimet e procedurës, bazuar në nenin 452 të LPK-së, duke i’u njohur paditëses shumë prej 125.00 euro, shpenzime këto të cilat i’u referohen shpenzimeve për pagesën e taksës për padi në shumë prej 21,00 euro, si dhe për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Vushtrri-

Departamenti i Përgjithshëm për Çështje Civile

C.nr.1076/2024, datë 31.05.2024

Gj y q t a r i
Naim Rekalio

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.